

**MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV SHIAK”**

Baza ligjore: Neni 7 pika 21, neni 33, pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VËREN SE:

Shoqëria “Media +” sh.a., është licencuar nga KKRT-ja, me vendimin nr. 30, datë 14.11.2000 si operator televiziv privat vendor në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për televizionin “TV Shijak”. Me vendimin nr. 698, datë 16.7.2008 është vendosur rinovimi i licencës së subjektit për një periudhë prej 5 vitesh. Licenca e subjektit ka përfunduar në datën 3.1.2011.

Në përfundim të afatit të licencimit, me shkresën nr. 1205 prot., datë 14.9.2010, KKRT-ja ka njoftuar subjektin për përfundimin e afatit, duke i kërkuar depozitimin e dokumentacionit për rinovim. Duke qenë se subjekti nuk kishte depozituar dokumentacion, KKRT-ja në mbledhjen e datës 28.3.2011, ra dakord t'i linte subjektit televizion "TV Shijak" një afat prej 30-ditësh për depozitimin e dokumentacionit për rinovim licence.

KKRT-ja konstaton se subjekti, përveç mungesës së interesit për rilicencim, ka detyrime të pashlyera ndaj KKRT-së dhe Buxhetit të Shtetit. Në total ky detyrim është 4.184.000 lekë, nga të cilat pagesë për licencë 2.645.600 lekë dhe taksë për shërbimet rtv 1.538.400 lekë.

Neni 33 i ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: “Licenca bëhet e pavlefshme kur:

1. mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar;

...

5. kërkuksi...nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijëni zyrtarisht për miratimin e saj”.

Në mbështetje të nenit 137/3 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për t’i dhënë mundësi të licencuarit të japë mendime, para marrjes së vendimit për heqjen e licencës, KKRT-ja, me shkresën nr. 112 prot., datë 18.1.2013, ka njoftuar televizionin privat vendor “TV Shijak”.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 1; dhe 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën nr. 039/ TVL të subjektit televiziv privat vendor “TV Shijak”.
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijeni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati